



Në përgjigje të shkresave tona, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ka sqaruar se më datë 17 Dhjetor 2017, ka përpiluar një Plan-Masash *“Për zbatimin e masave në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, para, gjatë dhe pas zhvillimit të protestës të Partisë Demokratike, më datë 18 Dhjetor 2017, nga ora 0.9.00 -13.00, para Parlamentit në Tiranë”*, duke iu referuar dhe bazës ligjore.

Sipas saj, nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit të angazhuar me detyra për mbarëvajtjen e këtij tubimi janë marrë të gjitha masat dhe janë zbatuar me korrektësi të gjitha kërkesat e nenit 133 “a” të ligjit 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*. Nga situata e krijuar gjatë zhvillimit të tubimit nga Policia Gjyqësore janë kryer dhe veprimet e nevojshme hetimore procedurale duke arrestuar në flagrancë 6 shtetas për veprat penale *“Kundërshtimi i punonjësve të policisë”*, apo janë lënë në gjëndje të lirë persona të tjerë si dhe 8 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Mandej, materialet procedurale hetimore i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka rregjistruar procedimin penal nr.10213/2017.

Në kuadër të hetimit, janë marrë deklarime disa shtetasve, pjesëmarrës në protestë si, z.H. V., z.B. M., dhe z.E. M., të cilët kanë shpjeguar se gjatë zhvillimit të protestës kanë qënë korrekt në sjellje e qëndrime duke mos kryer asnjë veprim të paligjshëm. Mandaj, pas përfundimit të protestës ata janë larguar në vëndbanimet e tyre pranë familjeve, apo duke kryer normalisht aktivitetin e biznesit që ata kanë.

Gjatë hetimit të pavarur administrativ rezultoi se, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, kishte shpallur në kërkim policor disa persona, pjesëmarrës në protestën e datës 18 Dhjetor 2017, si shtetasit B. M., O. L., F. H., F. N., etj. Këta persona janë ndaluar nga Policia e Shtetit në vëndkalimet kufitare të Republikës së Shqipërisë, ndërsa kalonin me familjet e tyre në Republikën e Kosovës ose të Maqedonisë, në një kohë që prej Policisë Gjyqësore nuk kishte njoftim për paraqitje në Polici.

Ky veprim bie ndesh me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vëndbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit”*.

Po ashtu, ai bie ndesh dhe me nenin 13 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, datë 10 Dhjetor 1946, ku thuhet: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brënda kufijve të çdo shteti. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vënd qoftë, përfshirë këtu dhe të vetin, si dhe të kthehet në vëndin e vet”*.

Shqetësim i qytetarëve pjesëmarrës në protestë, ishte dhe kryerja e fotografimeve apo filmimeve në mënyrë të dukshme të gjithë protestuesve nga punonjës policie me uniformë, apo në raste të tjera dhe bërja e fotografive nga persona civilë për identifikimin e protestuesve, veprim që ne e çmojmë se duhet të sjellë domosdoshmërisht marrjen e masave për kufizimin e intimidimit të protestuesve.

Dokumentimi fotografik nga ana e Policisë së Shtetit për elementë që mund të shkaktojnë shkelje të rendit e sigurisë, apo forma të tjera shkeljesh ligjore, është ligjore dhe një praktikë normale dhe e kuptueshme e punës së institucionit ligjzbatues të Policisë së Shtetit.

Mirëpo, nga ana tjetër autoritetet duhet të tregohen të kujdesshme për të përdorur dokumentet vizive të siguruara përmes fotografimit, apo filmimit vetëm për qëllimin që ligji u lejon këtë të drejtë.

Shqetësim tjetër i qytetarëve pjesëmarrës në protestë ishin dhe paraqitja e një numeri të konsiderueshëm të efektivëve të policisë, shkuarja në orët e vona të natës në banesat e tyre, mosrespektimi i kërkesave të parashikuara në nenin 108 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, për njoftimet në polici me anë të fletëthirrjes, apo në atributetet e Policisë Gjyqësore duke respektuar kërkesat e neneve 133 dhe 134 të Kodit të Procedurës Penale.

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur kushtetues këtë rast e ka parë dhe vlerësuar në kuadër të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, dhe në respekt e zbatim të Kushtetutës, nenit 2 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe akteve ndërkombëtare të nxjerra për këtë qëllim.

E drejta për t’u tubuar të lirë dhe për të protestuar në përputhje me ligjin është një e drejtë kushtetuese për qytetarët shqiptarë, si dhe një e drejtë themelore e njeriut.

Rregullat proceduriale që disiplinojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e kësaj të drejte, janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr.8773, datë 23.4.2001 “Për Tubimet”. Theksojmë se e drejta e tubimit, që prej këtij viti, nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti për miratim nga organet e policisë. Për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë, ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte, duke i dhënë kohë për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit. Është me rëndësi që të sjellim në vëmendje se, fryma pozitive e ligjit aktual, reflektohet në mënyrë të qartë në nenin 12 të tij, ku parashikohet zhvillimi i tubimeve në vendet e hapura për publikun pa bërë njoftim paraprak të policisë sipas nenit 5 të ligjit.

Parë në këtë frymë, dhe sjellja e strukturave të Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit duhet të jetë e kujdesshme dhe profesionale sa i përket ushtrimit të ndjekjes penale, ndaj pjesëmarrësve pas largimit të tyre nga vendi i organizimit të tubimit të paligjshëm.

Në këtë kontekst i kemi sugjeruar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që në Planin e Masave, të parashikohet një trajtim i kujdesshëm me qëllim që personelit të shërbimit gjatë instruksionit t’ju shpjegohet për këto raste duke i sqaruar dhe ndërgjegjësuar se, pjesëmarrja e qytetarëve në protestë është e lirë. Për rrjedhojë, ushtrimi i së drejtës së tubimit duhet të bëhet në mënyrë korrekte dhe ligjore dhe se ushtrimi i detyrave të organeve të rendit publik nuk duhet bërë në mënyrë të tillë që të kufizojë apo pengojë ushtrimin e të drejtës së tubimit.

Pas kërkesës sonë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na është vënë dispozicion Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme Nr.56/1 datë 27.05.2013, “Për Përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave”. Është pika 2 e Udhëzimit e cila në 10 paragrafet e saj përcakton kriteret se, kur konsiderohen persona në kërkim shtetasit shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi. Vihet re se në pjesën dërrmuese të tyre gjetjet e paraqitura janë llogjike dhe ligjore.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për shpalljen në kërkim policor të qytetarëve pjesëmarrës në protesën e datës 18 Dhjetor 2017, është bazuar në Pikën 2, paragrafi 2.8 i Udhëzimit ku thuhet: “*Persona në kërkim konsiderohen ata persona për të cilët policia dhe strukturat e ngarkuara me ligj kanë të dhëna/informacione se kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale*”.

Sipas parashikimit të sipërpërmëndur në rast se strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit kanë të dhëna/informacione se po përgatitet kryerja e një veprë penale, ata në radhë të parë duhet të marrin masat e nevojshme për ta parandaluar atë. Por kur informacioni apo të dhënat flasin se është kryer vepra penale, me atributet e Policisë Gjyqësore menjëherë duhet të kryhen veprimet e nevojshme hetimore procedurale duke vënë në dijeni prokurorin dhe më pas, veprohet në zbatim urdhërave të delegimit të Prokurorit.

Jemi në dijeni të faktit se pas daljes së Udhëzimit të mësipërm të Ministrit të Brendshëm ka patur ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin procedural penal, me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, për mbrojtjen e të drejtave të palëve në procesin penal, si dhe personin për të cilën organi procedues ka ngritur një akuzë, të pandehurit apo personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. I tillë është Ligji nr.35/2017 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905 datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar.

Në këto dispozita procedurale parashikohet fakti se për ngritjen e akuzës ndaj një personi, nga organi procedues dyshimet duhet të jenë të arsyeshme dhe të bazuara në prova, kurse gjykata jep vendime fajësie kur personi rezulton fajtor për faktin që i atribuohet vepra penale përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ligjëvënësi në kuadrin e procesit të rregullt ligjor e ka zgjeruar mbrojtjen e interesave të të akuzuarit në procesin penal duke detyruar organin procedues ku, “*prokurori kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*”( Nenit 304 Pika 1 e Ligjit Nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar).

Mbetemi konseguent në qëndrimin tonë se personat duhet të konsiderohen në kërkim kur:

*Së pari:* Duhet të jenë autorë ose persona të dyshuar në kryerjen e veprës penale, ndaj të cilëve organet e drejtësisë kanë lëshuar urdhër ndalimi, si dhe çdo urdhër tjetër të bazuar në ligj. Kështu dhe në nenin 253 të Kodit të Procedurës Penale, thuhet se “*është prokurori ai që urdhëron ndalimin e personit kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikje*”.

*Së dyti:* Kur pas kryerjes së veprës penale personi është larguar nga vëndi i banimit, me qëllim për t’u fshehur drejtësisë.

Me qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për shpalljen në kërkim të personave, do të sugjeronim:

1.Në Pikën 2 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, persona në kërkim konsiderohen shtetas shqiptarë, të huaj ose pa shtetësi të cilët kërkohen nga strukturat e Policisë së Shtetit,

Paragrafi 7 (2.7) “*Autorët ose të dyshuarit e larguar nga vëndi ngjarjes*”, të përmirësohet, me frazën: “*Personat për të cilët ka dyshime të bazuara për kryerjen e veprës penale dhe që janë larguar nga vëndi i ngjarjes, vëndi i banimit apo i punës*”.

2. Paragrafi 8 (2.8) “*Personat për të cilët policia dhe strukturat e ngarkuara me ligj kanë të dhëna/informacione se kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale*”, të

**shfuqizohet**, pasi vjen në kundërshtim me ligjin dhe aktet ndërkombëtare, në cënim të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve.

Sugjerimi i mësipërm argumetohet dhe me faktin se të gjithë personat e shpallur në kërkim nga Policia e Shtetit, si pjesëmarrës në protestën e datës 18 Dhjetor 2017, janë pyetur nga Policia Gjyqësore si për rastet e ndalimit në kufi, ashtu edhe kur ata janë paraqitur vetë, në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për hetimin, çka tregon se edhe informacionet e marra ndaj tyre kanë qënë pa vlerë, duke prodhuar dhe efekte negative.

Kërkesa e jonë për përmirësim dhe shfuqizim të paragrafeve respektiv të këtij udhëzimi, është në harmoni me ndryshimet dhe përmirësimet e fundit të dispozitave përkatëse në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe ajo që është më e rëndësishme, vullneti i shprehur në këtë akt duhet të synojë arritjen e një qëllimi të mirë dhe pa pasojë juridike në dëm të interesave të qytetarëve.

Problemi është parë në një kuadër më të gjërë, pasi dhe protestat paqësore të qytetarëve kanë qënë një çështje që ne e kemi trajtuar gjërësisht gjatë viteve 2017-2018.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës tonë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në nenin 24/b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:*

*b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mos shqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive”* **JU,**

### **REKOMANDOJMË**

*“Përmirësimin e paragrafit 7-të dhe shfuqizimin e paragrafit 8-të të Pikës 2 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.56/1 datë 27.05.2013, “Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave”.*

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**